

Mbërrin për herë të parë kroçera “Ocean Majesty”

-455 turistë nga Turqia në tur mesdhetar 10-ditor-

455 turistë të huaj, kryesisht nga Turqia kanë mbërritur sot paradite në portin detar në bordin e kroçerës “Ocean Majesty”. Pas kroçerës “Arion” (që do të mbërrijë përsëri nesër në Durrës) si dhe kroçerave “Island Sky” dhe “Kristina katerina” kjo është anija e pestë turistike që ankorohet në Durrës që nga fillimi i sezonit turistik. Anija turistike “Ocean Majesty” mbërrin për herë të parë në portin më të madh të vendit dhe sipas të dhënave të agjencisë përkatëse deri në tetor ajo do të lundrojë drejt Durrësit çdo fillim muaji.

Kroçera “Ocean Majesty” është nisur nga Korfuzi (Greqi) për një tur mesdhetar 10 ditor. Turistët nga Turqia pasi kanë vizituar ishujt dhe qytetet turistike të Greqisë dhe Turqisë (Korfuz, Pire, Izmir, Rodos, Ardios, Nikolas, Santorini, Mykonsk, Thesali) kanë mbërritur sot në Durrës, stacioni i vetëm shqiptar para përfundimit të turit në portin kroat të Dubrovnikut.

Turistët nga Turqia do të vizitojnë gjatë ditës qendrat më të rëndësishme arkeologjike të Durrësit, ndërsa disa grupe janë nisur me autobuzë drejt Tiranës dhe Krujës.



